



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 2069 Prot

Tiranë, më 23.03 2022

NJOFTIM

Drejtuar: Autoriteteve dhe Enteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në zbatim të detyrave të saj ligjore, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik, sipas parashikimeve të nenit 23, gërma "ç" të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", sjell në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore se, Këshilli i Ministrave ka miratuar së fundmi:

1. Aktin Normativ Nr. 5 datë 12.03.2022 "*Për disa shtesa në Ligjin Nr. 8450 datë, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"*, i ndryshuar;

Akti i mësipërm, duhet të mbahet në konsideratë nga autoritetet/entet kontraktore, që do të zhvillojnë procedura prokurimi për objektet e përcaktuara në të.

Gjithashtu, për efekt të transparencës, APP do të publikojë në faqen e saj të internetit, konkretisht në linkun <http://app.gov.al/>, si dhe në rubrikën "Njoftime", konkretisht në linkun <http://app.gov.al/njoftime/njoftime-2022/>, informacionin që do të dërgohet çdo ditë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sa i takon përditësimit të çmimeve të tregjeve ndërkombëtare të publikuara për artikujt e karburanteve të tilla, si: Benzinë, Gazoil, Mazut, Solar, Vajgur, Jet, Gaz i lëngshëm (Butan, Propan), Biodiesel (dhe të gjitha nënproduktet). Duke ju falënderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

